



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
BORDI

VENDIM

Nr. 101, Datë 09.05.2022

MBI

KËRKESËN E SHOQËRISË “ALB - ENERGY” SH.P.K., PËR RINOVIMIN E LICENCËS NR. 367, SERIA T17, NË VEPRIMTARINË E TREGTIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE, DHËNË ME VENDIMIN E BORDIT TË ERE-S NR. 65, DATË 11.05.2017

Në mbështetje të nenit 16, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; nenit 10, pikat 1, 2 dhe 3, nenit 16, pika 1, të Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike, të miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.06.2016, e ndryshuar; nenit 19, pika 1, gërma “a”, të Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat të ERE-s, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.06.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 09.05.2022, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 608/7 prot., datë 06.05.2022, të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, “Mbi kërkesën e shoqërisë “ALB – ENERGY” sh.p.k. për rinovimin e licencës nr. 367, Seria T17, në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, dhënë me vendimin e bordit të ERE-s nr. 65, datë 11.05.2017”,

Konstatohet se:

- Shoqëria “ALB – ENERGY” sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 6281 prot., datë 04.05.2022, ka paraqitur kërkesë dhe dokumentacion për rinovimin e licencës nr. 367, seria T17, në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, dhënë me vendimin e bordit të ERE-s nr. 65, datë 11.05.2017.
- Shoqëria “ALB – ENERGY” sh.p.k., ka depozituar një dokumentacion të konsiderueshëm bashkëlidhur aplikimit të saj për rinovim të licencës në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, por ky aplikim nuk është paraqitur në afat, bazuar në nenin 16, pika 1, të “Rregullores procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike” e ndryshuar.
- Në mbështetje të nenit 10, pika 7, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, e ndryshuar, shoqëria mund të paraqesë një aplikim të ri për licencim brenda 1

(një) muaji nga marrja e vendimit të ERE-s për mosfillimin e procedurës për shqyrtimin e aplikimit dhe dokumentacioni i paraqitur për këtë aplikim do të konsiderohet i vlefshëm edhe për aplikimin e ri, i cili duhet të përmbajë bashkëlidhur dhe pagesën e diferencës prej 10.000 lekësh, që përkon me licencimin në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Të mos fillojë procedurën për rinovimin e licencës nr. 367, Seria T17, në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, dhënë shoqërisë “ALB-ENERGY” sh.p.k. me vendimin e bordit të ERE-s nr. 65, datë 11.05.2017.
2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë shoqërinë për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s,- brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI

Petrit AHMETI